



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 81, Datë 19 / 3 / 2018

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 130, datë 03.10.2017, të paraqitur nga subjekti ankues D.Q, kundër Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues deklaroi se, në mesin e muajit Korrik 2017 është thirrur në zyrë nga nëndrejtori ekonomik, M.G (ekspozent i PS) dhe i është kërkuar dorëheqja me arsyen se ishte anëtar i LSI-së. Pas refuzimit të dorëheqjes, me urdhrin nr. 283/1, datë 21.07.2017 është ulur në detyrë nga pozicioni përgjegjës i IT në pozicionin operator në sektorin e IT. Me kërkesën nr.298, datë 25.07.2017 ankuesi ka kërkuar bazën ligjore dhe arsyet e uljes në detyrë por nuk ka marrë përgjigje. Më pas ka dalë një urdhër tjetër i cili urdhëronte D.Q që të kryente shërbimin e rojës, detyrë të cilën e ka kryer për një periudhë një mujore. Këtë urdhër, D.Q e ka kundërshtuar me shkresën nr. 298/1, datë 04.08.2017, por që nuk ka marrë përgjigje. Ankuesi pretendon se i është bërë presion se do largohet nga puna sapo të vijë drejtori i ri. D.Q me shkresën me nr.298/1 prot., datë 04.08.2017 i është drejtuar sërish Drejtorisë së Spitalit Rajonal Gjirokastrër lidhur me kërkesën e tij për rishikim të urdhërit nr.281/1, datë 21.07.2017 për uljen nga detyra, ku i bën me dije se ky është një veprim arbitrar dhe tendencioz nga ana e z/drejtorit administrativ.

Me shkresën me nr.435 prot., datë 08.11.2017 “Urdhër”, D.Q ka kaluar përkohësisht në funksion të Sektorit Teknik, me arsyetimin se në Sektorin e IT-s nuk ka qenë eficient.

¹ D.Q është anëtar i subjektit politik: “Lëvizja Socialiste për Integrim”.

Me shkresën me nr.438 prot., datë 09.11.2017 ankuesi i ka kërkuar Përgjegjësit të Sektorit Teknik, ku ishte kaluar me Urdhërin e sipërcituar, që t'i përcaktohej qartë puna dhe detyrat që duhej të kryente në këtë sektor. Me datë 17.11.2017, D.Q pretendon se i është komunikuar verbalisht pezullimi nga puna, me arsyetimin se nuk i ishte bindur Përgjegjësit të Sektorit Teknik. Lidhur me këtë situatë të krijuar, ankuesi me shkresën me nr.465 prot., datë 21.11.2017 i është drejtuar Drejtorisë së Spitalit, duke kërkuar t'i jepej fund sjelljes diskriminuese dhe të padrejtë ndaj tij.

Me shkresën nr.524 prot., datë 15.11.2017 D.Q i është drejtuar rishtaz Spitalit Rajonal Gjirokastrë, duke i kërkuar drejtorit të këtij institucioni të marrë masa për rregullimin e situatës së krijuar si dhe për ndalimin e diskriminimit ndaj tij.

Me shkresën me nr.494 prot., datë 22.12.2017 Drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastrë ka urdhëruar lirim të menjëhershëm nga detyra të D.Q.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 7/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

1. Duke qenë se ankesa e D.Q kishte mangësi të anës formale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresën nr.955/1, datë 06.09.2017 ka kërkuar nga subjekti ankues dokumentacion dhe informacion plotësues.

Me e-mailin datës 06.10.2017, subjekti ankues ka dërguar informacion dhe dokumentacion plotësues në lidhje me pretendimet e paraqitura.

2. Me shkresën me nr.955/2 prot., datë 20.10.2017 i është kërkuar informacion Spitalit Rajonal Gjirokastrë, lidhur me pretendimin e D.Q.

Megjithë tejkalimin e afateve të parashikuara në ligj për kthimin përgjigje, ky institucion nuk solli asnjë përgjigje shkresore.

3. Me shkresën me nr.955/3 prot., datë 23.11.2017 i është dërguar sërish kujtesë Spitalit Rajonal Gjirokastrë, duke sjellë në vëmendje detyrimin e tyre për të paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Me shkresën me nr.499/2 prot., datë 11/12/2017, Spitali Rajonal Gjirokastrë, ka kthyer përgjigje, por pa iu përgjigjur të gjitha kërkesave të specifikuar nga Komisioneri, si dhe pa e shoqëruar me gjithë dokumentacionin provues të kërkuar.

4. Me shkresën me nr.955/5 prot., datë 18.12.2017 Komisioneri i është drejtuar rishtaz Spitalit Rajonal Gjirokastrë, duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion të detajuar, specifikuar si në shkresë².

-
- ² Kopje të Rregullores së Brendshme dhe Rregullores së shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor (spitalor) të Spitalit Rajonal Gjirokastrë.
 - Kopje të përshkrimit të punës dhe kualifikimit për pozicionet: Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Teknologjisë, Operator në Sektorin IT dhe të gjitha pozicionet e Sektorit Teknik.
 - Procedurën dhe kopje të kualifikimeve të punonjësve që po kryejnë detyrën e Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Teknologjisë dhe Operator në Sektorin IT.
 - Vlerësimin e punës për vitet 2015 dhe 2016 për punonjësën D.Q.
 - Kopje të Urdhrave nr.283/1, datë 21.07.2017 dhe nr.302, datë 31.07.2017.
 - Kopje të dokumentacionit dhe procedurës së ndjekur për kalimin e z.Qenani nga pozicioni i punës, Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Teknologjisë në operator në Sektorin IT dhe më pas në Sektorin Teknik
 - Kopje të legjislacionit me të cilin rregullohet shërbimi i rojës në Spitalin Rajonal Gjirokastrë.
 - Kopje të urdhrat për kryerjen e shërbimit të rojës për punonjësën D.Q dhe listën e personave e periudhën kur kanë kryer shërbimin e rojës punonjës nga sektori i IT.
 - Shkresat përgjigje të Drejtorisë së Spitalit në lidhje me shkresat, Kërkesë të drejtuara nga D.Q, nr.298 prot, datë 25.07.2017, nr.298/1 prot, datë 04.08.2017, nr.438, datë 09.11.2017, nr.465 prot, datë 21.11.2017 dhe Memo nr.524, datë 15.11.2017².
 - Shpjegime dhe dokumentacion mbi pretendimin e D.Q për pagesën e muajit Nëntor 2017.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të disfavorshme nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës e ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri kishte për synim të siguronte informacionin e duhur dhe dokumentacionin mbështetës lidhur me rastin e D.Q, në mënyrë që të mund të dilte në konkluzione të qarta dhe objektive lidhur me pretendimin e tij për trajtim të pabarabartë dhe të disfavorshëm.

Mirëpo, nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, u dha informacion i përciptë, i mangët dhe pa dokumentacionin mbështetës, provues të kërkuar nga Komisioneri.

Komisioneri ka qenë i qartë dhe i drejtëpërdrejtë në kërkesat e tij, në mënyrë që të mund të realizonte një hetim të paanshëm, objektiv dhe të arsyetuar lidhur me verifikimin dhe provimin e pretendimit të D.Q.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Spitalit Rajonal Gjirokastrë. Pra, në këtë rast Spitali Rajonal Gjirokastrë duhet të provontë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshme.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Në nenin 85/2 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “Mosparaqitja e provave”, “Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret në konsideratë për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes...”.

Në këto rrethana, Komisioneri mbështetet kryesisht në dokumentacionin e sjellë nga pala ankuese. Nga këqyrja e dokumentacionit rezulton se subjekti ankues me urdhrin nr. 283/1, datë 21.07.2017 është ulur në detyrë nga pozicioni, përgjegjës i IT në pozicionin operator në sektorin e IT. Me shkresën me nr.435 prot., datë 08.11.2017 “Urdhër”, D.Q ka kaluar përkohësisht në funksion të Sektorit Teknik, me arsyetimin se Sektori i IT nuk ka qenë eficient. Me shkresën me nr.494 prot., datë 22.12.2017 Drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastër ka urdhëruar lirim të menjëheshëm nga detyra të D.Q.

Pra, siç shihet qartë të gjitha lëvizjet e mësipërme janë bërë në dëm të subjektit ankues duke përkeqësuar situatën e tij profesionale. Komisioneri konstaton se ai është kaluar nga një pozicion në tjetrin duke u ulur në detyrë, pa patur asnjë masë disiplinore ndaj tij³ dhe në kundërshtim me arsimimin e tij. Përfundimisht, ai është larguar nga puna, dhe lidhur me këtë Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër nuk ka sjellë asnjë argumentim që të përligjë këtë veprim të tyre.

Për sa më lart, Komisioneri gjen të pa arsyetuar dhe në shkelje të ligjit të gjitha masat përkeqësuese të ndërmarra në dëm të ankuesit, gjë që ka çuar në trajtim të disfavorshëm të tij.

Lidhur me gjithë ankesat e D.Q për diskriminim nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastër, drejtuar Drejtorisë së këtij institucioni, Komisioneri informon se, ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 12 të tij, pika 1, germa b) parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Neni 13, i po këtij ligji, parashikon masat që punëdhënësi duhet të ndërmarrë, duke përcaktuar se: “...Punëdhënësi është i detyruar: të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloji diskriminimi; të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e

³ Kjo rezulton nga këqyrja e dosjes së tij personale. (Inventari i dosjes).

dijenisë; t'u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre”.

Për sa më lart, Komisioneri konstaton se Spitali Rajonal Gjirokastrë, jo vetëm nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke mos marrë asnjë masë për të rregulluar situatën, por përkundrazi, e ka përkeqësuar atë deri në largimin përfundimtar të ankuesit nga puna.

Lidhur me këtë, Komisioneri vëren se, ankesën pranë KMD-së D.Q e ka paraqitur me datë 03.10.2017, dhe pasojat rënduese në vijim apo masat e ndërmarra nga Spitali Rajonal Gjirokastrë kanë ardhur kryesisht pas kësaj date⁴ dhe kanë ardhur si rezultat i këtij ankimimi.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar në nenin 3, pika 8 të tij, se: *“trajtimi i disfavorshëm apo pasoja negative, që vjen si reagim ndaj një ankimimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë është “Viktimizim”.*

Komisioneri vlerëson se ndjekja e rrugëve ligjore për të kërkuar dhe rivendosur një të drejtë të cënuar është e drejtë legjitime e çdokujt.

Komisioneri konstaton se Spitali Gjirokastrë e ka diskriminuar ankuesin në formën e viktimizimit, (për shkak se të gjitha pasojat në dëm të ankuesit nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë kanë ardhur pas depozitimit të ankesës së tij pranë KMD-së). Kështu, verifikohet se me datë 21.07.2017 D.Q është ulur në detyrë nga pozicioni përgjegjës i IT në pozicionin operator në sektorin e IT. Me datë 08.11.2017 ka kaluar përkohësisht në funksion të Sektorit Teknik. Me datë 22.12.2017 Drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastrë ka urdhëruar lirimin e menjëheshëm nga detyra të D.Q. Ndërkohë që ankesën pranë KMD-së e ka depozituar me datë 03.10.2017.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit *“Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”.* Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore. Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi.

Referuar datave të kalimit nga Sektori IT në Sektorin Teknik, si dhe datës së liritimit të tij nga detyra.⁴

Në këtë kuadër, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar⁵, dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, gërma c) parashikohet se: “... Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... c) bërja e një padie ose pjesëmarrja në proces kundër një punëdhënësi që përshijnë pretendim për shkelje të ligjeve ose rregullave dhe ankim te autoritetet administrative kompetente”.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së⁶. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj kuadër që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10 221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Për sa më lart, Komisioneri konstaton se ankuesi është trajtuar në mënyrë të disfavorshme për shkak të bindjeve politike të tij. Kjo bindje përforcohet nga tendenca dhe veprimet arbitrare dhe në shkelje flagrante të ligjit nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

B. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesi si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj tij nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁷ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankuesit.

- **Pretendimi i D.Q se shkak për diskriminim ndaj tij janë bërë bindjet e tij politike, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.**

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë nga hetimi, Komisioneri gjykon se, shkak për të gjitha pasojat e krijuara në dëm të ankuesit, janë bërë bindjet politike të tij.

- a) Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, referuar kartës së anëtarësisë nr.6404, datë 24.09.2016, rezulton se D.Q është anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe delegat i zgjedhur për të përfaqësuar anëtarët e kësaj force politike të qytetit të Gjirokastrës në Konventën zgjedhore të subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” në datë 05.11.2017.

⁵ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

⁶ Referuar nenit 3, pika 8 e LMD-së.

⁷ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

- b) Po ashtu, ankesa e sjellë pranë KMD-së ka shërbyer si shkak për të përkeqësuar marrëdhënien e tij me punëdhënësin. (Faktuar nga kronologjia e ngjarjeve të cituara në vendim).
- c) Marrëdhëniet në punë të ankuesit dhe situata e krijuar mes tij dhe Spitalit Rajonal Gjirokastër janë acaruar direkt pas zgjedhjeve parlamentare të Qershorit dhe janë intensifikuar pas konventës së LSI-së me datë 05.11.2017, ku D.Q ishte delegat i zgjedhur⁸.
- d) Nga ana e punëdhënësit, Spitali Rajonal Gjirokastër nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se përkeqësimi i situatës së tij deri në largimin e tij nga puna, nuk ka ardhur për pasojë e bindjeve të tij politike apo si rezultat i ankimit të tij pranë KMD-së.

Për sa më sipër, Komisioneri gjen të provuar dhe të mbështetur në argumente bindëse dhe në ligj, se bindjet politike të ankuesit dhe ankimi pranë KMD-së kanë çuar në trajtimin e pafavorshëm, të padrejtë dhe të paligjshëm të tij, nga ana e punëdhënësit, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër. Në këtë kontekst, në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Komisioneri vlerëson se D.Q i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues, krahasuar me parashikimet e legjislacionit të brendshëm, kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është autoriteti garantues i nenit 18 të Kushtetutës të RSH-së ku parashikohet parimi i barazisë sipas të cilit të gjithë qytetarët duhet të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm për të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore.

Neni 34, pika 1, e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcakton se: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1, të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente, për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimi përpara organeve kompetente për ndjekje penale”. Në nenin 37, pika 1 e këtij ligji, parashikohet se: “Vendimi i Gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit”.

Po kështu, neni 38 i po këtij ligji parashikon se: “Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e dëhur për dëmet pasurore dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”.

Komisioneri i rekomandon subjektit ankues që bazuar në sa më sipër citohet mund t’i drejtohet gjykatës për dëmshpërblim.

⁸ Refruar Mandatit të Delegatit të LSI, dokument cili ndodhet në Dosjen e ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 20, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe në formën e viktimizimit për shkak të ankimimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të D.Q, nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: bindja politike)
(fusha: punesim)